

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **ZYRA E PROKURIMIT, KOMUNA DRENAS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **611-19-023-521**

Sa i përket tenderit për : **KANALIZIMI I UJERAVE TE ZEZA NE FSHATIN NEKOC, KIZHAREKE, FUSHTICË E EPERME DHE ULËT DHE SANKOC**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

N.N.P. "PROING"

NEKOC - DRENAS

KOMUNA DRENAS

13000

(Kodi postar)

044/691-691

AJET DEMIRI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnpproing@gmail.com

(Adresa elektronike)

02/05/2019

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. B05 Njoftimi për kontratë - me datë 01/03/2019
2. B12 Hapja e ofertave me datë 27/03/2019 ora 14,00h (përmes platformes elektronike E.prok.)
3. B47 Letër standarde e kërkeses për sjelljen e vertetimeve 08.04.2019
4. B42 Letër standarde për tenderusit e eliminuar 30/04/2019
5. Kriteri për dhënie Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ultë

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

JO X

Ofertat janë hap me datë 27/03/2019 – PERMES PLATFORMES ELEKTRONIKE PA VËREJTJE

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

PO X

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

ËSHTË SHKELË LPP-JA NË;

1. Neni 1 qëllimi
2. Neni 6 ekonomiciteti
3. Neni 7 barazia dhe trajtimi
4. Neni 59 shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave
5. Neni 60 kriteret e dhënies
6. Neni 71, pika 1, 2, 3



7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

KRITERI I DHËNIES SË KONTRATËS, TENDERI I PËRGJEGJSHËM ME ÇMIM MË TË ULTË

Shkeljet:

1. **Neni 1 i LPP-se , Qëllimi i Ligjit, citojmë:** Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
2. **Neni 6 i LPP-se , Ekonomiciteti dhe efikasiteti i Ligjit, citojmë:** Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
3. **Neni 7 i LPP-se, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i Ligjit, citojmë:** Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
4. **Neni 59 i LPP-se, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave dhe**
5. **Neni 60 i LPP-se, Kriteri i dhënies, Tenderi i përgjegjshëm, Qmimi më i ulët**
6. **Neni 71 pika 1, 2 dhe 3 të LPP-së per te cilin eshte dashte te kerkohet sqarime , pra eshte dashte te veprohet konform Nenit 39 pika 8 e RRUOPP faqe 86, ku thuhet se nese mungon Qertifikata TVSH mund te kerkohen sqarime.**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e shkaktuara:

1. Humbja e besimit dhe imazhit të kompanisë ne vazhdimsi per punët me radhë.
2. Humbja e vendeve të punës për disa punëtor që për momentin janë të angazhuar dhe do ta shtonim numrin e puntorve në rast që kjo kontratë do të ishte nënshkruar.
3. Humbja e tregut për punet që do t'i ofrojmë në rast që do ishim shpallë fitues.

4. Humbja e mjeteve të konsiderueshme financiare nga të cilat kompania do të ecte përpara në afarizmin e vet.
5. Edhe autoriteti kontraktues –Komuna ka humbje pershkak se keme afruar qmim te volitshem ne ket ofertë.
6. Po shifet qart se vlersimi nga ana e komisionit vlersues ashtë i ngutshem dhe nuk i kan zbatuar kriteret e ligjit te prokurimit duke shkelur te gjitha ligjet e Prokurimit Publik vetem e vetem të arrin qellimin e tyre dhe te me eleminojn pa të drejtë.
7. Pa kurfarë baze Ligjore jemi anuluar dhuqe u shkelur të gjitha Ligjet e Prokurimit Publik dhe duke vepruar në kundërshtim me këto ligje edhe ate:
8. **Neni 59 i LPP-se, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave dhe**
9. **Neni 60 i LPP-se, Kriteri i dhënies, Tenderi i përgjegjshëm, Qmimi më i ulët**
10. **Neni 71 pika 1, 2 dhe 3 të LPP-së per te cilin eshte dashte te kerkohet sqarime , pra eshte dashte te veprohet konform Nenit 39 pika 8 e RRUOPP faqe 86, ku thuhet se nese mungon Qertifikata TVSH mund te kerkohen sqarime.**

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtejshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit:

NE PROPOZOJMË:

1. Që zyra prokurimit – Drenas që tenderin ta kthejë në **Ri-vlerësim** dhe te zbatohet ligji i prokurimit konform neneve të LPP-së të cekura më lartë. Pra te pezullohet aktiviteti i prokurimit dhe te caktohet nje komision tjetër i pa anshëm i vlersimit i Rivleresimit.
2. Zyra e Prokurimit Publik nuk mundet të kerkoi dokumentet - vertetimet tatimor pa i marrë nënshkrimet nga ana e komisionit në kundërtën përbën shkelje ligjore.
3. Komisioni nuk ka të drejt në asnjë mënyrë që pë qellime krejtësisht personale dhe krejtësisht i një anshëm me informata të rrejshme dhe për qellime të damtimit të buxhetit Komunal kanë bërë shkelje ligjore sipas ligjeve në fuqi.
11. **Neni 59 i LPP-se, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave dhe**
12. **Neni 60 i LPP-se, Kriteri i dhënies, Tenderi i përgjegjshëm, Qmimi më i ulët**
13. **Neni 71 pika 1, 2 dhe 3 të LPP-së per te cilin eshte dashte te kerkohet sqarime , pra eshte dashte te veprohet konform Nenit 39 pika 8 e RRUOPP faqe 86, ku thuhet se nese mungon Qertifikata TVSH mund te kerkohen sqarime.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- b) Një kopje të publikimit për “Njoftimin për eliminim” B42
- c) Kërkesën për qasje në dokumentacionin e Fituesit

